



Tregu i Fundvitit

Rregullat e aplikimit për periudhën 2016/17

QËLLIMI

Tregu i Fundvitit, aktivitetet ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës në prag të festave të fundvitit ka për synim mbështetjen e bizneseve të vogla. Këto të fundit do të kenë rastin të bëjnë shitjen e produkteve ushqimore, suvenireve dhe kartolinave punëdore në 20 shtëpiza të drurit të cilat do të vendosen në sheshin “Zahir Pajaziti”.

RREGULLAT E TREGUT TË FUNDVITIT

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e Tregut të Fundvitit do të bëhet javën e tretë të nëntorit në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe do të qëndrojë e hapur deri me 03 Janar 2017. Gjatë kësaj kohe bizneset e përzgjedhura për shtëpiza lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 09:00 deri në orën 23:00.

2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në Tregun e Fundvitit do të bëhet nga një komision në Komunën e Prishtinës. Numri i shtëpizave do të jetë i kufizuar. Aplikimi i kriterëve si më poshtë do të jetë përcaktues në mënyrë që përzgjedhja e bizneseve të jetë sa më adekuate:

- Bizneset do të aplikojnë për: ëmbëlsira, ushqim të shpejtë, produkte brumërash, pije të ngrohta, suvenire si dhe dhurata e kartolina punëdore me motive të festave të fundvitit;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë pajisur me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Tregun e Fundvitit;
- Bizneset aplikuese duhet të paraqesin ofertën me çmimore për artikuj;

- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore do të trajtohen me prioritet.

3) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës

Tarifat për shfrytëzimin e shtëpizave të tregut të fundvitit janë përcaktuar duke u bazuar në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku pagesa aplikohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Pra, bizneset e selektuara do të jenë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej **10.00 Euro për m²** për periudhën e shrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

4) Distribuimi i shtëpizave

Numri total i shtëpizave shfrytëzuese do të jetë 20 sosh ku secila do të jetë e dalluar me numrin që i takon. Të gjitha bizneset të cilat aplikojnë të parat, do të kenë mundësinë e përzgjedhjes së lokacionit ku do të vendoset shtëpiza. Distribuimi do të bëhet pasi që të përfundojë procesi i selektimit të bizneseve pjesëmarrëse.

5) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetësohet sa më mirë, Komuna e Prishtinës gjatë 45 ditëve të Tregut të Fundvitit ndalon rreptësisht aktet si më poshtë

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme mbrenda zonave të zhvillimit të tregut;
- Abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse konkurruese, si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;
- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërën prej shtëpizave;
- Obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën rreth saj.

Nëse nuk zbatohet kodi i mirësjelljes i sqaruar më lartë, bizneset do të sanksionohen me marrjen e lejës për shtëpizë si dhe nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzim të saj.